



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.24/2018

Prishtinë, më 21 qershor 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj Halimaj.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Syla dhe Fisnik Ismaili.

Stafi mbështetës i komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Haki Sadriu, Nike Prela, Ibrahim Haxhiu, Selim Zyberi dhe Gezim Maloku-Shoqata 27 Prilli, Flutur Murtezaj dhe Adelina Hasani-KDI, Maja Maroviq-US Embassy, Flora Kryeziu-Unicef, Amire Qamili-BIRN, Albana Hajdari-Kosova Post, Donika Osmani-Ekonomia Online, Mejreme Tahirukaj-Radio Kosova dhe Zenel Hajrizi-RTK.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara;
2. Raportimi në Komision në lidhje me zhvillimin e punimeve në Kompleksin Memorial në Meje. Të ftuar: Shoqata e familjarëve të personave të zhdukur "27 Prilli 1999-Meje" dhe përfaqësues të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë;
3. Të ndryshme.

1. **Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara**

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 2 maj 2018 dhe 10 maj 2018, nuk u hodhën në votim fare.

2. Raportimi në Komision në lidhje me zhvillimin e punimeve në Kompleksin Memorial në Meje. Të ftuar: Shoqata e familjarëve të personave të zhdukur "27 Prilli 1999- Meje" dhe përfaqësues të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë

Kryetarja, falënderoi anëtarët e shoqatës 27 Prilli që i janë përgjigjur ftesës së Komisionit, për të njoftuar me shumë me punimet që po kryhen në atë kompleks memorial, me ç'rast ua dha fjalën përfaqësuesve të shoqatës.

Haki Sadriu, tha se për këtë memorial posedojmë argumente, kemi dokumente fotografi dhe jemi përcjellës të projektit, ndërsa sa i përket tenderit, tha se si shoqatë nuk kanë qasje, nuk e dinë hapjen e as fituesin e tenderit. Sa u përket punimeve në atë kompleks, prej ditës së parë ka lëshime, dhe lëshimi më i madh është se gabimet janë mbuluar me beton, me pllaka dhe tani është duke u vendos edhe graniti. Nuk e dimë si punohet atje, derisa lënda është në prokurori.

Kryetarja, tha se në mbledhje të komisionit e kishim prezent drejtorin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, ndërsa është thënë se si shoqatë keni kërkuar vendosjen e një graniti i cili nuk ekziston në tregun e Kosovës dhe se ka një çmim të shtrenjtë dhe se ky lloj graniti ekziston vetëm në Afrikë.

Nikë Prela, tha se sa i përket llojit të granitit, ka edhe në tregun e Kosovës dhe shumica e varrezave në Kosovë janë të punuara me atë material. Ne si familjarë jemi të zhgënjyer se si një investim kaq kapital bëhet pa u respektuar normat e ndërtimit dhe jemi që kjo mos të vazhdojë në këtë mënyrë, por të merr formën e rregullt të ekzekutimit të punimeve.

Teuta Haxhiu, tha se ndihet keq që nuk është edhe përfaqësuesi i Agjencisë për Menaxhimin e Memorialëve. Ankesat e shoqatës dhe familjarëve i kam marrë me 27 prill, kur isha në Meje, ajo çka me ka bërë përshtypje ka qenë thyerja e varrezave që nuk e kemi kuptuar arsyen që sipas z.Blakaj janë thyer prej familjarëve.

Do të doja të dijë se a është çmimi i kësaj pllake larg çmimeve të pllakave të tjera. Është përmendur se tenderi është hapur nga agjencia, ndërsa në vitin 2017 është ndërpre kontrata me një kompani që ka filluar projektin. A mund të ndodhë që ndërprerja e kontratës të sjellë edhe shpenzime të tjera dhe u premtoi se do ta kenë përkrahjen e komisionit pa rezervë.

Haki Sadriu, tha se thyerja e varrezave është bërë me kërkesë të organizatës që merret me bartjen e mbetjeve mortore prej morgut dhe varrosen, ndërsa qeveria i paguan ata. Ne vetëm i tregojmë vendin e varrezave dhe atë ditë kanë qenë prezent i tërë komisioni qeveritar me përjashtim të z.Gjetaj.

Saranda Bogujevci, tha se sa i përket pjesës së punimeve në atë kompleks, e kemi vendosur edhe si pjesë të rezolutës, e cila ka dalë nga seanca e Kuvendit, e mbajtur më 27 Prill 2018, që

të përfundohet puna në Memorialin në Meje deri në fund të këtij viti. Kemi biseduar edhe për mundësinë e vizitës tek memoriali që të shohim më për së afërmi punët që janë bërë deri më tani. Ajo tha se i intereson të dijë, cila ka qenë përfshirja e z. Gjetaj në këtë proces të ndërtimit të memorialit, dhe a keni shkresa apo ndonjë dokument përcjellës që i keni dërguar komisionit njoftim për çështjen e rivarrimit të pjesëve të trupave, dhe nëse keni është mirë t'i përcillni tek ne në Komision.

Lirije Kajtazi, tha se të prekësh në memorialë është më shumë se krim, tani e dimë që lënda është në prokurori, por çka do që konsideroni që ne mund t'ju ndihmojmë për të lëvizur procesin për të mirë, mos na kurseni.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se ndër veprimet e para që i kemi bërë për këtë çështje, ka qenë takimi me përfaqësuesin e Agjencisë për Mbrojtjen e Memorialëve, pastaj të takohemi me ju dhe të shkojmë edhe në vendin e ngjarjes të shohim se çka është bërë. Kjo çështje është dërguar edhe në Prokurori dhe besoj se do të zgjidhet drejt. Ajo u interesua të dijë për çështjen e ndërprerjes së kontratës, se a ka qenë kjo për shkak të vërejtjeve tuaja që ti ndërpritet puna një kontraktuesi që ka punuar keq dhe ti jepet një kontaktuesi tjetër për të përfunduar punën si duhet.

Haki Sadriu, tha se në një takim që ishim me kryetaren e Komunës është thënë se në pamundësi buxhetore, detyrohen të heqin dorë nga projekti. Kjo ka qenë shprehja e saj dhe ne nuk kemi pasur mundësi as me e ndal, e as me e shty procesin. Pjesa e dytë kur ka kaluar në mbrojtjen e monumenteve, pra ka hy në mbrojtje institucionale. Jemi ndier më të kënaqur po në atë vit është premtuar edhe përfundimi i punimeve. Ne i kemi kërkuar kryetares që pjesë e ndërtimit të këtij memoriali të jetë edhe firma Fidani, dhe ne as sot nuk e dimë se cila është firma kontraktuese dhe kush i kryen punimet.

Saranda Bogujevci, drejtori i Agjencisë për Mbrojtjen e Memorialëve ka lënë të kuptohet se ka pasur probleme në Komunë pastaj për atë arsye është bartur në Agjencia, do të thotë Komuna e Gjakovës, kur e ka pasur përsipër projektin, punët kanë shkuar mirë dhe e vetmja arsye që është bartur në Agjencia ka qenë buxheti.

Haki Sadriu, neve në takim na është thënë që kjo bartet vetëm për mungesë të buxhetit.

Teuta Haxhiu, tha se kërkesa për ndërprerjen e kontratës ka qenë e Komunës.

Salim Zymeri, tha se na është thënë që ky është një projekt madhor dhe se Komuna nuk e përballon dhe duhet atë ta marrë Qeveria, dhe për ta lejuar menaxhimin e Agjencisë është dashur të bëjë ndërprerjen e kontratës në mënyrë të njëanshme. I kanë paguar mbi 130 mijë euro dënim, kurse sa i përket z. Gjetaj, tha se gjithmonë është angazhuar për manifestime dhe ka qenë një njeri që na ka ndihmuar, por nuk ka pasur autoritet për të marrë vendim.

Nikë Prela, tha se i kemi marrë model varrezat e dëshmorëve në Landovicë dhe kjo nuk është diçka e re.

Saranda Bogujevci, tha se nëse nuk ka pasur Komuna buxhet, me rishikim të Buxhetit Kuvendi ka pas mundësi t'i dërgojë buxhet shtesë Komunës së Gjakovës për këtë projekt.

Kryetarja, tha se do ta përcjellim këtë rast dhe në emër të Komisionit, ju keni përkrahje deri në fund.

Salih Zyba, tha se për këtë çështje duhet të dilet me një përfundim, dhe ti jepet zgjidhje kësaj çështje. Këto elemente të kontratave, qoftë si vlera që janë paguar, qoftë si vija buxhetore duhet me i dit si Komision se deri ku ka shkuar rasti ngase me një vizitë kjo nuk mjafton.

Mirjeta Kallura, tha se ne duhet me e pa kontratën që është bërë me komunën e Gjakovës, se si është bërë shkëputja e kontratës dhe pse, mandej të kalojmë te Agjencia për Menaxhimin e Memorialëve.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se le ti liston kolegu Salih disa hapa në formë të shkruar dhe na ndihmon në këtë proces.

Salih Zyba, theksoi se i drejtohem i komunës me një shkresë zyrtare, ku kërkohet dokumentacioni bazë dhe elementet përcjellëse të kontratës për memorialin, ashtu siç është quajtur herën e parë. Atë dokumentacion e analizojmë dhe i gjejmë elementet e saj, ky është një proces i gjatë por jo i mundimshëm.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se ftesa për herë të dytë në komision e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Memorialëve ka qenë gabim. Është një komision teknik që ka me bërë pranimin teknik të atij memoriali në fund, nëse nuk i shohin punimet në rregull, nuk e pranojnë dhe nuk i bëhet pagesa kompanisë.

Mirjeta Kalludra, pyeti se sa është e gjithë vlera e Kompleksit Memorial në Meje.

Saranda Bogujevci, tha se nëse pajtoheni është mirë me një e-mail ti adresohemi Komunës së Gjakovës dhe të kërkojmë projektin bazë dhe procedura deri në momentin kur i është ndërpre kontrata kompanisë, dhe prej aty mandej me i marrë të dhënat nga agjencia edhe ato të dhëna i analizojmë e pastaj vendosim për hapat e mëtejme.

3. Të ndryshme.

Duda Balje, tha se Ministrisë së Arsimit, ju kemi drejtuar me një shkresë për Informata për mundësinë e shkollimit të personave të moshës madhore, të cilët nuk kanë vijuar shkollën. Ne e kemi pranuar një shkresë nga ministri, ku thuhet se kanë një udhëzim administrativ.

Saranda Bogujevci, propozoi që të ftohet në takim Komisioni Qeveritar, i cili është duke i ndarë pensionet për gratë e dhunuara gjatë luftës, sepse ka informacione që janë marrë vendimet por ato ende nuk janë duke i marrë pensionet.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje